



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE  
DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE  
DIREKCIJA ZA ZDRAVSTVO I SOCIJALNU ZAŠTITU



Bazuar në nenin 67.dhe 68.të Ligjit për Zyrtarët Publik,nr.06/L-114,nenin 8. të Ligjit të Punës nr.03/L-21 2,nenin 4.të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017,për rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Vendimit të këshillit Drejtues, të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare :“Dr.Fatmir Krasniqi” Fushë Kosovë,nr.515,të dt.06/06/2022 dhe Aprovimit të Propozimit nr.505 të dt.06/06/2022 nga DSHMS,Drejtori i QKMF“Dr.Fatmir Krasniqi” Fushë Kosovë,shpall:

## KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Për themelimin e mardhënies së punës me afat të pacaktuar

### I.Titulli i vendit të punës:Teknik/e i/e Farmacisë

- Institucioni:Komuna Fushë Kosovë
- Drejtorati: Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Lloji i pozitës:Nëpunës i Shërbimit publik
- Numri i Pozitave: 1 ( një)
- Titulli i mbikqyrësit:Farmacitit/es,Drejtorit të-QKMF-së
- Grada/koeficienti: H-68 Gr./St. H-377 4.8
- kohëzgjatja e emërimit: Në kohë të pacaktuar
- Vendi i punës: QKMF “Dr.Fatmir Krasniqi”Fushë Kosovë

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Detyrat e punës: -  
Organizon punën në Barnatoren e QKMF,  
Kontrollon dhe përgadit barërat dhe preparatet që ndodhen në Barnatore,  
Kontrollon afatin e vlefshmërisë së barërave dhe materialit tjetër shëndetësorë,  
I jep barnat pacientëve sipas reçetës së Mjekut,  
Kujdeset për konditat e nevojshme për ruajtjen e barërave,  
Kryen porosinë e barërave,  
Përgadit raporte pune dhe raporte javore,mujopre e vjetore,  
Kujdeset për deponimin adekuat të barërave me afat të skaduar dhe eliminimin e tyre,  
Kryen regjistrimin vjetorë të barërave dhe materialit shëndetësor.  
Kryen edhe punë të tjera sipas udhëzimeve të Shefit të Depos Qëndrore dhe Drejtorit dhe iu përgjigjet atyre për punën e vet.

### Kushtet dhe kriteret:

- të jet shtetas i/e Republikës së Kosovës (kopja e Letërnjoftimit),
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- të zotërojë një rën nga gjuhët zyrtare,në pajtim me Ligjin mbi gjuhët,
- të jetë i/e aftë në pikëpamje shëndetësore (Certifikata e mjekut,pas pranimit në mardhënie pune),

- të mos jet i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (dëshmi me shkrim nga Organi kompetent),
- të mos ketë në fuqi një masë dënimore për largim nga një pozitë e Zyrtarit publik,
- të ketë të kryer Shkollën e mesme të Mjekësisë, Drejtimi: Farmaci (Diploma ose Certifikata-fotokopje),
- personat që kanë diplomuar jashtë R.së Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuara diplomat në MASHT,
- të jetë i/e regjistruar dhe licencuar në M.SH. (Licenca e punës),
- të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara,
- të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip,
- të ketë njohuri të punës me Kompjuterë,
- të ketë kategorinë "B" të vozitjes (e dëshirueshme) dhe
- të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, etnie, religjioni ose race.

#### Dokumentacioni i nevojshëm

- të ketë të kryer aftësimin adekuat profesional,
- të jetë i regjistruar në M.SH. (licenca e punës),
- formulari mbi aplikacionin (i plotësuar),
- syzhea personale-CV,
- certifikatë se nuk jeni nën hetime (origjinali),
- dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- certifikata e mjekut (pas përzgjedhjes nga Komisioni).

#### INFORMATË E PËRGJITHËSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

##### Mënyra dhe afati i aplikimit

Pranimi në detyrë, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. Procesi përzgjedhës do të bazohet gjithashtu në një proces profesional, transparent e të drejtë, bazuar në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, ku përfshihet një testim me shkrim dhe me gojë.

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net>, është nga data: 09/06/2022, deri më: 08/07/2022.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve, është 15 ditë, nga data: 11/07/2022, deri më: 25/07/2022, ditëve të punës, nga ora 08,00 deri në ora 15,00.

Përveç webfaqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës, <http://kk.rks-gov.net/fushëkosovë>.

Aplikacionet merren në Arkivë e Komunës ose mund të shkarkohet nga web-faqja zyrtare e Komunës së Fushë Kosovës, dhe të plotësuara dorëzohen personalisht në Arkivë ose dërgohen me postë në adresën: QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë, Rruga "Bedri Pejani" p.n..

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakumpletuara nuk do të pranohen.

Drejtor,  
Dr. Osman Maxhera